

**Marrëveshje Bashkëpunimi
midis**

**Universitetit "BARLETI"
Tiranë, ALBANIA**

dhe

**Cooperativa OSA (Operatori Sanitari Associati)
Romë, Itali**

dhe

**Health Community Training srl (HC Training)
Romë, Itali**

Universiteti "Barleti" (UniBa) Tiranë (Albania), Kooperativa "OSA" (Operator Shëndetësor të Asociuar) dhe HC Training srl marrin pjesë në Marrëveshjen e Bashkëpunimit të paraqitur me qëllim, zbatimin dhe mbështetjen e bashkëpunimit ndërmjet palëve duke rënë dakord si më poshtë:

I. QËLLIMI I MARRËVESHJES

Qëllimet e kësaj marrëveshje janë aktivizimi dhe krijimi i programeve të bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve në fushën akademike dhe arsimore, si dhe bashkëpunimi në interes të përbashkët për një sërë aktivitete të arsimit të lartë dhe tematikash të orientuara drejt kërkimit shkencor. Në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, palët synojnë të ndërmarrin llojet e mëposhtme të bashkëpunimit (lista shembull, por jo shteruese):

1. Organizimi i përbashkët i programeve arsimore afatshkurtra, shkolla verore/dimërore, programe specifike me certifikim etj.
2. Organizimi i kurseve pasuniversitare për studentët shqiptarë me orientim profesional për plotësimin e kriteve për transferim në Itali. Profesionet si: Infermier, Punonjës i përkujdesit Shëndetësor dhe Social, Psikolog, Fizioterapist etj.
3. Kurse përditësuese afatshkurtra, plotësuese të studimeve universitare dhe mundësi punësimi për studentët ekselentë dhe integrimin e tyre në tregun italian të punës.
4. Shkëmbim i njohurive, i praktikave të mira dhe teknologjive laboratorike etj.
5. Shkëmbim i personelit profesional, teknik dhe laboratorik, kurse të përbashkëta të formimit profesional.



6. Lëvizshmëri dhe shkëmbim i personelit pedagogjik/mësimdhënës, stafit laboratorik dhe teknik.
7. Planifikim dhe koordinim i ndërsjellë i ofertave arsimore, praktikave dhe formimit profesional.
8. Mundësi punësimi të sapo diplomuarve për studentët pasuniversitar pjesëmarrës në programet e ofruara.
9. Qendra Resursesh: krijimi dhe ndarja e materialeve dhe burimeve edukative; shkëmbimi i materialit akademik të botuar dhe hyrja në bazat e të dhënave të bibliotekave dixhitale.
10. Aktivizimi i laboratorëve dhe qendrave të shërbimeve komunitare etj.
11. Kërkimi i aplikuar dhe inovacioni.
12. Organizimi i konferencave, seminareve, trajnimeve dhe workshope.
13. Pjesëmarrja në programe, projekte dhe programe të promovuara nga fondet e BE-së dhe rajonet. IPA / Erasmus + etj.
14. Transferimi i modelit të shërbimeve shëndetësore tek familjet, komunitetet dhe iniciativa të tjera të biznesit në kuadër të shërbimit shëndetësor.
15. Investime/sipërmarrje të ndryshme biznesi në fushën e Shkencave Mjekësore, Mirëqenies dhe Shëndetit.
16. Aktivitete të përbashkëta: Platforma dhe Portale Informativë, Forume dhe Konferenca, Takime dhe Workshope.

II. PLANI I PUNËS / NËNMARRËVESHJE

Kjo marrëveshje bashkëpunimi, do të plotësohet me plane pune më të detajuara (protokoll bashkëpunimi) bazuar në projekte në vazhdim ose në ato të planifikuara tashmë.

1. Aktivitetet, detyrat, rezultatet e pritura, seksioni financiar dhe zërat përkatës do të specifikohen për çdo plan pune.
2. Në fund të çdo plani pune, rezultatet do të komunikohen dhe vlerësohen nga përfaqësuesit e palëve.

III. ZBATIMI

Të gjitha programet ose aktivitetet e implementuara sipas kushteve të këtij protokoll bashkëpunimi duhet të dakortësohen reciprokisht me shkrim, duke përfshirë buxhetin për realizimin e programeve ose aktiviteteve të përcaktuara sipas nevojave të rastit.

Institucionet pjesëmarrëse do të jenë plotësisht përgjegjëse nga pikëpamja financiare për aktivitetet e kryera nën drejtimin e tyre ose nga stafi i tyre, përveç, rasteve kur palët bien dakord ndryshe.

Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare (IRO) dhe/ose departamentet përkatëse dhe/ose personeli akademik i emëruar, do të zhvillojnë dhe koordinojnë programe ose aktivitete specifike në një mënyrë të dakorduar.



UNIVERSITETI
BARLETI



IV. KOHËZGJATJA DHE RIPËRTËRITJA E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi do të hyjë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga përfaqësuesit e të tre institucioneve me një kohëzgjatje prej 5 (pesë) vitesh dhe do të rinovohet automatikisht. Çdo rishikim ose ndryshim i kësaj marrëveshje duhet të kryhet me miratim të përbashkët dhe me shkrim.

V. SHITESAT

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi mund të ndryshohet me shkrim dhe të nënshkruhet nga përfaqësuesit e palëve.

Në rast të ngjarjeve/problemeve të paparashikuara që lindin gjatë aktiviteteve të bashkëpunimit në të dy vendet, palët bien dakord të jenë në gjendje të negociojnë një zgjidhje të pranueshme/të përshtatshme për të palët e përfshira.

VI. AFATI I MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT

Në çdo kohë gjatë afatit të saj, kjo Marrëveshje Bashkëpunimi mund të revokohet nga secila prej palëve vetëm, pas njoftimit me shkrim, jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj përpara datës së përfundimit të saj, me kusht që një zgjidhje e tillë të mos ndikojë në plotësimin e cdo programi ose aktiviteti në vazhdim në momentin e njoftimit të përfundimit.

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi është nënshkruar në dy kopje origjinale. Secila palë ruan një kopje origjinale të nënshkruar.

Prof. Dr. Suzana Guxholli

Rektor



Data: 17.06.2022

Nr. 781/1, Prot

Daniele Palumbo

Cooperativa Sociale e di Lavoro
Operatori Sanitari Associati
Via Lucio Volturno, 1 - 00178 Roma
C.F. 07056830586 - P.IVA 0167574008
Administratori Deleguar

Data: _____

Angelo Caciolo

HC TRAINING Srl
Via Vallerotonda, 13 - 00178 Roma
C.F. e.P. IVA 07718661007
President Cda

Data: _____